




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014 me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të dt. 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjiçanit marr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej **1000 (njëmijë euro)** për Naimë Ismailin për mbulimin e një pjesë të shpenzimeve të shërimit. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi Buxhetor – Zyra e Kryetarit të Komunës.
2. Mjetet derdhen në xhirlogarinë e Naimë Ismailit [REDACTED]
3. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për Subvencionim e përfutjesit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.


Vendimi i dorëzohet

- Palëve,
- DBF, dhe
- Arkivit.


Kryetari i Komunës

Alban Myshani





KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GJILLANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI



MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM

ndërmjet

**Komunës së Gjiçanit, si autoritet publik
dhe**

Naimë Ismaili, përfitues

Gjiçan, 2023

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja financiare për Naime Ismaili nga Gjilani, për mbulimin e shpenzimeve për trajtimin e sëmundjes së Sklerozës Multiple (Sclerosis Multiplex), sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren 01. nr. 016-126422 dt. 29.12.2016 e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 2/208,01 nr. 016-28468 dt. 22.03.2018 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve (neni 22 paragrafi 1.8)

Neni 2
Vlera e Subvencionimit

1. Vlera e subvencionimit është shuma prej 1000 € (një mijë euro) dhe ndahet nga Kodi Buxhetor – Zyra e Kryetarit të Komunës.
2. Kjo është shuma e vetme dhe përfundimtare që paguhet nga Komuna e Gjilanit për përfutuesin.

Neni 3
Obligimet e palëve

1. **Obligimet e përfutuesve të subvencionit janë :**
 - 1.1. mjeket e marra, përfutuesit do t'i shfrytëzojnë vetëm për qëllimet e paraqitura në Kërkesë.
 - 1.2. përfutuesit duhet të raportojnë tek Komuna e Gjilanit brenda 30 ditëve, pas afatit për përfundimin e marrëveshjes.

2. Përfutuesit duhet të sjellin tek Komuna e Gjilanit:

- 2.1. raportin narrativ (shtojçë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje) raportin financiar për mjeket e shpenzuara (shtojçë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje).
- 2.2. njofton Komunën e Gjilanit për çdo vonesë në realizimin e qëllimeve të subvencionimit.

1. **Obligimet e Komunës së Gjilanit janë:**
Neni 4

- 1.1. obligohet që shumën nga paragrafi 1 i nenit 2 të kësaj marrëveshjeje, t'ia transferoj në xhirologarinë bankare të përfutuesit, sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshjeje;
- 1.2. bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.

2. Komuna e Gjilanit mbanë të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.

Neni 5
Afatet kohore

1. Afatet kohore të kësaj marrëveshjeje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetër në rast të vonesave.

2. Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

Neni 6
Shkëputja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje mund të shkëputet në rasti të:

- 1.1. tejkalimit të pa justifikuar të afateve kohore të parapara me këtë marrëveshje;
- 1.2. marrëveshjes me shkrim nga të dyja palët në marrëveshje;
- 1.3. shpenzimit të mjeteve për qëllime tjera që nuk janë paraqitur me këtë marrëveshje dhe
- 1.4. mos realizimit të subvencioneve për shkaqe objektive.

Neni 7
Kthimi i mjeteve

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve apo zvogëlojnë punën sipas vëllimit të parapartë me projekt, përfutjesit janë të obliguar t'i kthejnë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.

Neni 10
Marrëveshja është përpiluar në 2 kopje të njëjta për secilën palë.




Naime Ismaili